

Si COVID-19 Mund të Ndikojë në Varfërinë dhe Mirëqënien e Familjeve në Ballkanin Perëndimor¹

- COVID-19 dhe masat kufizuese do të frenojnë uljen e varfërisë dhe rritjen e mirëqënies në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Përveç ndikimeve në shëndet dhe përdorimin e shërbimeve, ka të ngjarë që kriza të ndikojë edhe në mirëqënien e familjeve kryesisht përmes uljes së numrit të vendeve të punës dhe të ardhurave nga punësimi në sektorët më të prekur, si dhe pakësimin të remitancave të dërguara nga jashtë.
- Në mungesë të masave të qeverive në përgjigje ndaj krizës, më shumë se 400,000 njerëz në rajon mund të zhyten në varfëri ndërsa klasa e mesme do të tkurrej ndjeshëm.
- Shumica e njerëzve që mund të bien në varfëri për shkak të krizës COVID-19 aktualisht nuk përfitojnë mbrojtje sociale, dhe në rast se nuk do të këtë zgjerim të programeve, më të rrezikuar rezultojnë të punësuarit informalë që nuk përfitojnë nga sigurimet e papunësisë dhe masa të tjera mbështetëse për ekonominë formale.
- Përtej masave për mbrojtjen e shëndetit publik, qeveritë e rajonit duhet të minimizojnë efektet negative në ekonomi dhe varfëri duke siguruar ofrimin e shërbimeve bazë utilitare dhe sociale si dhe duke lehtësuar krizën e të ardhurave, veçanërisht për punëtorët më të cenueshëm.

COVID-19 po i çon ekonominë e Ballkanit Perëndimor drejt recesionit, duke shkaktuar ndërprerje në uljen e varfërisë dhe rritjen e mirëqënies që këto vende po përjetonin kohët e fundit. Përpara krizës së COVID-19 në fillim të vitit 2020, shumica e vendeve të rajonit kishin bërë progres të dukshëm në drejtim të uljes së varfërisë dhe rritjen e të ardhurave të familjeve.² Megjithatë, në vitin 2019, rreth 19.7 përqind e popullsisë së rajonit akoma jetonte me më pak se 5,50 dollarë në ditë (PPP 2011) për person - pragu i varfërisë standarde për vendet me të ardhura të mesme të larta - ndërsa një numër i konsiderueshëm ishte pranë kufirit të varfërisë.³ Kriza ka të ngjarë të ndërpresë dhe pjesërisht të përmbysë arritjet e fundit. Ky shënim ilustron efektet e mundshme të COVID-19 në shpërndarjen e të ardhurave dhe varfërinë në Ballkanin Perëndimor.⁴ Dokumenti shqyrton kanalet e transmetimit: se si COVID-19 mund të prekë të varfërit dhe grupe specifike të popullsisë në rajon. Ai paraqet, në një ushtrim simulimi me vlerësim sasior, humbjet që mund të shkaktohen nga reduktimi i orëve të punës, të ardhurat nga punësimi dhe remitanca të jashtë. Për shkak të shpejtësisë me të cilën po zhvillohet kjo situatë dhe pasigurisë së lartë që e

¹ Ky shënim është përgatitur nga ekipi i Bankës Botërore për varfërinë dhe drejtësinë në shpërndarje në Ballkanin Perëndimor, që përfshin Leonardo Lucchetti, Trang Nguyen, Ana Maria Oviedo dhe Jayne Yoo. Enrique Blanco Armas, Alexandru Cojocaru, Facundo Cuevas, Alan Fuchs Tarlovsky, Edith Kikoni, Maria Ana Lugo, Marc Tobias Schiffbauer, Dhiraj Sharma, Gallina Vincelette, dhe Salman Zaidi dhanë komente dhe sugjerime të dobishme.

² Për thjeshtësi, ky shënim kryesisht përdor të ardhurat si tregues të matjes së mirëqënies, megjithëse për Kosovën dhe Bosnjën dhe Hercegovinën është përdorur konsumi.

³ Përgjatë këtij shënimi, vlerësimet e varfërisë bazohen në pragu 5.50 dollarë (PPP 2011) për person në ditë për të gjitha vendet, përveç Bosnje-Hercegovinës, ku varfëria bazohet në pragu 205 KM në muaj. Shkalla rajonale e varfërisë llogaritet si një mesatare e ponderuar e vlerësimeve të vitit 2019 të varfërisë së vendeve me popullsitë e tyre, duke përdorur të njëjtën bazë. Shkalla rajonale e varfërisë nuk përfshin Bosnjën dhe Hercegovinën për shkak të mungesës së të dhënave të krahasueshme.

⁴ Rekomandime se çfarë vendet mund të bëjnë për të minimizuar efektet negative në varfëri dhe shpërndarjen e të ardhurave mund të gjenden në shënimet shoqëruese të RER, përfshirë shënimin me titull "Alternativa për përgjigjet e mbrojtjes sociale ndaj COVID-19 në Ballkanin Perëndimor".

shoqëron atë, simulimet mbështeten në skenarë të mundshëm të ndërtuar në bazë të informacionit aktualisht të disponueshëm. Ato demonstronjë se në mungesë të masave të hartuara me kujdes të politikave në përgjigje ndaj krizës, COVID-19 mund të ketë pasoja të rënda negative mbi varfërinë dhe mirëqenien e familjeve në rajon. Ndonëse të gjithë janë prekur nga COVID-19, më të dëmtuar nga kjo situatë mund të jenë grupet e varfra dhe të cenueshme pasi ata kanë më pak akses në shërbime dhe më pak kursime dhe mekanizma për të përballuar situatën.

Kanalet e transmetimit të goditjeve agregate të shkaktuara nga COVID-19 tek individët

Përveç pasojave të drejtpërdrejta në shëndet, kriza e COVID-19 mund të ketë edhe shumë efekte të tjera në mirëqenien individuale dhe familjare, siç janë:⁵

1. më pak vende pune dhe rrjedhimisht rënie të të ardhurave nga punësimi për shkak të zvogëlimit të kërkesës dhe ndërprerjes së furnizimeve;
2. më pak të ardhura nga burime të ndryshme nga punësimi, veçanërisht nga remitancat e dërguara nga ata që kanë emigruar në BE;
3. rënie e mundshme e të ardhurave reale nëse ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit çojnë në rritje të çmimeve apo në racionim të mallrave të konsumit bazë si ushqimi, ose të dyja bashkë;
4. presion mbi ofrimin e shërbimeve dhe ndërprerje në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale (të trajtuara në shënimet e tjera të RER), duke rrezikuar në këtë mënyrë mosplotësimin e nevojave të grupeve të tilla të cenueshme si fëmijët nga grupe të disavantazuara, të moshuarit, dhe personat me aftësi të kufizuara.

Një humbje e tejzgatur e të ardhurave, sidomos për familjet e varfra që nuk kanë kursime, sigurime dhe mekanizma përballimi, do të dëmtonte aftësinë e tyre për të investuar në arsimin, ushqyerjen dhe shëndetin e fëmijëve dhe nënave, duke shkaktuar pasoja të rënda në planin afatgjatë.

Efektet kryesor ekonomik për qytetarët e Ballkanit Perëndimor si rezultat i pandemisë do të jetë rënia e të ardhurave nga punësimi. Kjo do të prekë ndoshta fillimisht të punësuarit në sektorët më të cenueshëm nga kriza, por eventualisht do të shtrihet edhe në sektorë të tjerë, formalë dhe informalë, të ekonomisë. Në fakt, kriza pati ndikim të menjëhershëm tek të punësuarit në sektorët e hotelarisë, argëtimit, transportit, shitjes me pakicë të artikujve jo-ushqimorë dhe në disa sektorë të prodhimit industrial (p.sh. fasoneritë, automjete). Para krizës së COVID-19, rreth 48-65 për qind e punëtorëve në vendet e Ballkanit Perëndimor ishin të punësuar në sektorë mesatarisht ose shumë të prekur nga kriza (shiko Tabela A.1 në Aneks) dhe ata do të vijojnë të ndiejnë pasojat, si nga humbja e vendeve të punës ashtu dhe nga rënia e të ardhurave. Një shënim i veçantë i këtij RER-i për punësimin "Tregjet e Punës të Ballkanit Perëndimor dhe goditja e COVID-19" trajton në mënyrë të detajuar sektorët më të prekur nga kjo krizë dhe shkallën e dëmtimit të tyre në secilin prej vendve të rajonit.

Veçanërisht të rrezikuar janë personat e vetëpunësuar, me punësim informal dhe ata me punë të përkohëshme ose me kontrata jo shumë të sigurta. Këta kanë më shumë gjasa të humbasin vendet e punës, të punojnë më pak ose t'u ndërpriten përkohësisht marrëdhëniet e punës, në krahasim me të punësuarit formalë me kontrata përhershme. Gjithashtu tepër të rrezikuar janë dhe të punësuarit në ekonominë gig dhe ata që nuk mund të punojnë nga shtëpia. Shumë prej këtyre të punësuarve, shpesh herë në mënyrë informale, nuk paguajnë sigurime shoqërore dhe nuk kanë të drejtë të përfitojnë pagesën e papunësisë në rast se humbasin punën e tyre. Masat e qeverisë në përgjigje ndaj krizës, të cilat ndihmojnë firmat në sektorin formal të ruajnë vendet e punës nuk do të mund të arrijnë drejtpërdrejt te

⁵ "Efektet e COVID-19 në varfëri dhe shpërndarjen e të ardhurave: Kanalet e mundshme të ndikimit dhe politikat zbutëse", Praktika Globale e Varfërisë dhe Barazisë e Bankës Botërore, 3 Prill 2020.

punësuarit informalë. Shumë prej këtyre të punësuarve informalë ose të të vetëpunësuarve nuk janë përfitues të të asistencës sociale, mjetit të fundit mbrojtës të rezervuar për më të varfërit, duke i lënë ata të pambrojtur. Rreth 14 deri 33 për qind e të punësuarve në sektorët shumë të prekur nga kriza e COVID-19 në ekonominë e Ballkanit Perëndimor janë të vetëpunësuar, e për këtë arsye ata janë edhe më të cenueshëmit (Figura 1). Kjo përqindje është veçanërisht e lartë në Shqipëri dhe Kosovë. Aftësitë e punëtorëve në sektorët e prekur nga kriza në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi janë disi më të ulëta se në sektorët e tjerë. Edhe paga mesatare në sektorët e prekur nga kriza zakonisht është më e ulët se në sektorët e tjerë (përveç bujqësisë, e cila konsiderohet e paprekur nga kriza).

Gjithashtu edhe të ardhurat nga burime të tjera ka gjasa të bien për shkak të rënies së remitançave. Në vitin 2019, remitançat në vendet e Ballkanit Perëndimor varionin nga 2 deri në 10 për qind të PBB-së, ku Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova kanë varësinë më të madhe prej tyre.⁶ Punëtorët emigrantë, veçanërisht të punësuarit e përkohshëm ose informalë, mund të humbasin vendet e punës në vendet evropiane të goditura rëndë nga pandemia dhe izolimi. Disa nga këta emigrantë do të kthehen në vendet e tyre, duke rrezikuar të mbeten të papunë dhe pa mbrojtje sociale. Flukset hyrëse të remitançave për familjet në Ballkanin Perëndimor do të pësojnë rënie.


Individët e varfër dhe të cenueshëm mund të përballen me kosto të larta ekonomike dhe sociale. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës jo-të varfër rrezikon të bjerë në varfëri. Shpërthimi i epidemisë së COVID-19 do të godasë fort banorët e zonave urbane, veçanërisht ata me punë të pasigurta (informale) dhe që nuk do të mund të përfitojnë nga masat e marra për mbrojtjen e punësimit formal. Sasia e kufizuar e kursimeve, mbulimi i ulët me sigurime shoqërore dhe përdorimi relativisht i ulët i shërbimeve publike mund të çojnë në rëndim të efekteve negative afatgjata të krizës. Për më tepër, gratë dhe minoritetet, të cilët janë tradicionalisht më të cenueshëm nga dhuna në familje dhe diskriminimi social, mund të goditen më shumë nga masat kufizuese kundër COVID-19. Mbyllja e shkollave, kopshteve dhe çerdheve mund të rrisë barrën për nënat që duhet të qëndrojnë në shtëpi, duke ndikuar negativisht në punësimin e tyre. Izolimi social, masat kufizuese, kufizimet në udhëtim dhe nivelet e larta të stresit po shtojnë dhunën në familje, siç dëshmohet nga raportime të shumta mediatike dhe të OSHC-ve.⁷ Për shkak se të moshuarit janë relativisht më të predispozuar ndaj problemeve shëndetësore, ata janë më të rrezikuarit nga shpërthimi i pandemisë. Kjo çështje merr rëndësi të veçantë në Ballkanin Perëndimor, për shkak të plakjes së popullsisë në vitet e fundit. Së fundi, komuniteti rom dhe pakicat e tjera etnike përballen me rreziqe më të larta në lidhje me shëndetin dhe të ardhurat për shkak të aksesit të ulët në shërbime bazë dhe mundësi të kufizuara ekonomike.

⁶ Banka Botërore (2019) Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor: Vjeshtë 2019. <http://documents.worldbank.org/curated/en/643781570478210132/pdf/Rising-Uncertainties.pdf>

⁷ Shiko, p.sh., <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/4/statement-ed-phumzile-violence-against-women-during-pandemic>.

Figura 1: Gati një e treta e punëtorëve në sektorët e prekur nga kriza, kryesisht në Shqipëri dhe Kosovë, janë të vetëpunësuar dhe veçanërisht të rrezikuar ndaj humbjes së të ardhurave

Shpërndarja e punësimit sipas llojit, në sektorët mesatarisht ose shumë të prekur, në përqindje.



Burimi: Analiza të AMNJ dhe ABF.

Magnituda e mundshme e efekteve të COVID-19 në shpërndarjen e të ardhurave në Ballkanin Perëndimor

Ky shënim përdor metodën simulimit analitik për të vlerësuar efektet e mundshme të pandemisë dhe masave kufizuese mbi shkallën e varfërisë. Simulimet bazohen në përafrimin e rendit të parë të efekteve, përpara ndërmarrjes së masave të qeverisë në përgjigjeje të krizës, përmes disa kanaleve të transmetimit: të ardhurat nga secili sektor, lloji i punës dhe transfertat private të familjeve. Si tregues matës të varfërisë në Shqipëri, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi janë përdorur të ardhurat; si matës i nivelit të mirëqenies për Bosnjë dhe Hercegovinën dhe Kosovën është përdorur konsumi.^{8,9} Sektorët ekonomikë janë grupuar në tre kategori: (1) relativisht të paprekur, (2) mesatarisht të prekur dhe (3) shumë të prekur (shiko tabelën A.1). Punëtorët e vetëpunësuar supozohet të jenë relativisht më të prekur sesa punëtorët e paguar. Simulimet supozojnë dy skenarë: në skenarin 1, shpërthimi i pandemisë dhe masat e lidhura me kontrollin e saj zgjasin deri në fund të qershorit, dhe në skenarin 2, ato zgjasin deri në gusht. Vlerësimet e bëra i referohen efektit mesatar për të gjithë vitin, ndërsa ato do jenë më të rënda në një ose dy

⁸ Të dhënat e të ardhurave në anketat familjare shpesh nuk kapin të ardhurat më të larta. Para simulimit, të gjitha të ardhurat e viteve të mëparshme janë përdorur për vlerësimin afatshkurtër (nowcasting) të të ardhurave të vitit 2019 bazuar në rritjen e PBB-së reale për frymë, duke supozuar norma neto të interesit specifike për secilin vend.

⁹ Në disa anketime, të dhënat e të ardhurave mund të jenë më pak të besueshme se të dhënat e konsumit dhe të dy jo gjithmonë përputhen. Për shembull, në BH, të ardhurat e familjeve kanë qenë në mënyrë sistematike rreth një e treta më e ulët se shpenzimet për konsum të familjeve, pjesërisht për shkak se përlllogaritjen aplikohen në shpenzimet për konsum dhe jo sipas sipas matësve të të ardhurave. Për këtë arsye, rezultatet për BH janë të nënvlerësuar, duhet të konsiderohen si kufiri më i ulët i efektit dhe nuk janë plotësisht të krahasueshme me efektet në varfëri të vlerësuar për vendet e tjera në rajon. Sidoqoftë, simulimi i goditjeve të të ardhurave në BH është ende informues nëse rezultatet merren parasysh me këtë shpjegim (Banka Botërore. 2015. Rebalancimi i Bosnje dhe Hercegovinës: Një Diagnostikim Sistemik i Vëndit. Ëashington, D.C: Grupi i Bankës Botërore).

tremujorët më të goditur nga masat e shpërthimit të pandemisë dhe të kontrollit të saj. Shiko Shtojcën 2 për detajet e plota teknike të metodologjisë.


Vlerësimet për Ballkanin Perëndimor, pa përfshirë masat e reagimit të qeverive, tregojnë se kriza e COVID-19 mund të shkaktojë rënien e të paktën 400,000 njerëzve në varfëri, shifër e cila mund të arrijë deri në 950,000 në rast të zgjatjes në kohë të krizës. Figura 2 tregon se si mund të ndryshojë numri i personave në të tre kategoritë për shkak të COVID-19: Në të gjashtë vendet mijëra qytetarë do të binin në varfëri - duke përmbysur kështu progresin e bërë gjatë pesë deri tetë viteve të fundit në drejtim të reduktimit të varfërisë. Sipas skenarit të parë të simuluar, shkalla e varfërisë si rezultat i krizës së COVID-19 vlerësohet të rritet (sipas standardeve për vendet me të ardhura të mesme të larta)¹⁰ me 1-4 pikë përqindje (pp) në të gjashtë vendet (Figura 3). Varfëria do të rritet më shumë nëse kriza zgjat deri në Gusht, siç tregohet në skenarin 2, për shembull, nga 3 pp në Mal të Zi në 10 pp në Kosovë. Përqindja e numrit të personave të cenueshëm (që jetojnë me të ardhura nga 5,50 \$ në 11 \$ / ditë në PPP 2011) vlerësohet të rritet në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi, ndërsa në vendet e tjera, numri i personave që kalojnë nga grupi i cenueshëm në varfëri do të jetë më i madh se i atyre që kalojnë nga klasa e mesme në grupin e cenueshëm. Kriza gjithashtu do të ndikojë në uljen e pjesës së popullsisë ekonomikisht të sigurt (klasa e mesme dhe e lartë) në të gjitha vendet, me 3,5 pp sipas skenarit 1, dhe rreth 6-10 pp sipas skenarit 2.

Humbjet në të ardhura ka të ngjarë të vërehen në të gjithë segmentin e shpërndarjes së të ardhurave. Të ardhurat mesatare të familjeve supozohen të bien nga 3 deri në 12 për qind në të gjashtë vendet e rajonit. Figura 4 ilustron rënien në segmentet e shpërndarjes së të ardhurave për shkak të COVID-19. Humbjet në të ardhura për individët dhe familjet në kuintilin më të varfër mund të variojnë nga 3 për qind në BH deri në 5 për qind në Kosovë sipas skenarit 1, ose do të dyfishohen sipas skenarit 2. Të varfërit në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë, mbështeten më shumë në të ardhura të ndryshme nga puna dhe më pak në të ardhura nga punësimi në sektorët më të prekur nga COVID-19. Megjithatë, duke qenë se familjet e varfra nisen nga një bazë e ulët e të ardhurave që para krizës, humbja e të ardhurave mund të vërë në rrezik aftësinë e tyre për të plotësuar nevojat bazë dhe për të investuar në fazat kritike të zhvillimit njerëzor. Personat në kuintilin e dytë deri në atë të pestë do të përballen me ulje më të mëdha të të ardhurave, pasi të ardhurat që vijnë nga sektorët më të prekur nga kriza përbëjnë një pjesë më të madhe të totalit të të ardhurave të tyre.

¹⁰ Për shkak të mungesës së të dhënave të krahasueshme, shkalla e varfërisë në BH bazohet në një prag mujor 205 KM.

Figura 2. Shpërthimi i pandemisë COVID-19 do të rrisë ndjeshëm numrin e të varfërve

Ndryshimet e simuluar në numrin e personave të varfër (P), të cenueshëm (V), dhe të klasës së mesme (M-C) për shkak të COVID-19




Burimi: Simulimet e Bankës Botërore bazuar në të dhënat e të ardhurave për vitin 2017 sipas AMNJ për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë; Të dhënat e të ardhurave për 2015 sipas AMNJ në Mal të Zi; ABF 2015 për BH, dhe ABF 2017 për Kosovën.

Shënim: P = Të Varfër, V = Të Cenueshëm, dhe M-C = Klasa e Mesme. Treguesit e të ardhurave sipas AMNJ dhe të konsumit sipas ABF nuk janë rigorozisht të krahasueshëm midis tyre. Niveli Bazë = varfëria sipas vlerësimeve për vitin 2019 bazuar në të dhënat e anketave të familjeve në vitet e mëparshme dhe rritjen e PBB-së reale për frymë. Meqenëse shkalla e varfërisë në BH bazohet në pragun mujor 205 KM për frymë dhe matësi i mirëqenies për frymë është i reduktuar në çmimet e vitit 2007, numri i personave të cenueshëm dhe të klasës së mesme nuk mund të llogariten për këtë vend dhe rezultatet nuk janë të krahasueshme me vendet e tjera.

Figura 3. Shpërthimi i epidemisë së COVID-19 mund të shtyjë një pjesë të madhe të personave të cenueshëm drejt varfërisë.

Efekti i simuluar i krizës së COVID-19 sipas klasave ekonomike




Burimi: Simulime të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e të ardhurave për vitin 2017 sipas AMNJ për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë; Të dhënat e të ardhurave për vitin 2015 sipas AMNJ në Mal të Zi; ABF 2015 për BH, dhe ABF 2017 për Kosovën. Shënim: Skenari 1 = kriza zgjat tre muaj; Skenari 2 = kriza zgjat 6 muaj.

Shënim: Shiko Figurën 2 për shënime shtesë.

Figura 4. Të ardhurat e familjeve do të ulen përgjatë gjithë segmentit të shpërndarjes së të ardhurave.


Humbja e simuluar e të ardhurave për shkak të krizës së COVID-19 (%) sipas kuintileve të shpërndarjes së mirëqënies.



Burimi: Simulime të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e të ardhurave për vitin 2017 sipas AMNJ për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë; Të dhënat e të ardhurave për vitin 2015 sipas AMNJ në Mal të Zi; ABF 2015 për BH, dhe ABF 2017 për Kosovën.
Shënim: shiko Figurën 2.

Figura 5. Shumë prej të varfërve të rinj nuk marrin asnjë lloj ndihme ekonomike.

Përqindja e simuluar e popullsisë që nuk përfiton ndihmë ekonomike



Burimi: Simulime të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e të ardhurave për vitin 2017 sipas AMNJ për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë; Të dhënat e të ardhurave për vitin 2015 sipas AMNJ në Mal të Zi; ABF 2015 për BH, dhe ABF 2017 për Kosovën.
Shënim: shiko Figurën 2

Individët e punësuar në sektorët më të prekur nga kriza kanë përjetuar edhe rritje më të madhe të shkallës së varfërisë, edhe pse para krizës shumë prej tyre nuk kanë qenë pjesë e kategorisë më të varfër. Për shembull, vetëm 6 për qind e atyre që punojnë në sektorët më të prekur nga kriza në Mal të Zi (kategoria 3 në tabelën A.1) ishin të varfër më parë, por pandemia pritet të rrisë shkallën e varfërisë së tyre në 9 për qind sipas skenarit 1 dhe 13 për qind sipas skenarit 2.

Shumë prej të varfërve të rinj mund të mbeten pa përkrahje sociale në qoftë se nuk do të ketë zgjerim të programeve. Punëtorët informalë që humbasin punën nuk e përfitojnë pagesën e papunësisë. Ndonëse programet e asistencës sociale në Ballkanin Perëndimor janë përgjithësisht të mirë shënjestruara, mbulimi i të varfërve me këto programe ka qenë i ulët. Vetëm një pakicë e të varfërve të rinj po marrin aktualisht përkrahje sociale –për shembull më shumë se 75 për qind e tyre në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi (Figura 5). Pa politika në mbështetje të tyre, grupi i të varfërve të rinj që nuk përfiton nga pagesa e papunësisë ose asistencë sociale do të mbetet veçanërisht i cenueshëm nga kriza.

Përfundimet sipas vendeve

Shqipëria: Kriza e shkaktuar nga COVID-19 dhe masat kufizuese pritet të përmbysin arritjet e fundit në drejtim të reduktimit të varfërisë në Shqipëri. Në Mars, Shqipëria vendosi të mbyllë hotelet, teatrot dhe aktivitetet e tregtimit të artikujve jo-jetik si dhe kufizoi lëvizjen e njerëzve si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Shumë sektorë të industrisë, përfshirë tekstilet, minierat, qendrat telefonike dhe ndërtimi, u detyruan të zvogëlojnë veprimtarinë për shkak të zbatimit të masave për distancim social por edhe për shkak të rënies së kërkesës si rezultat i kolapsit të porosive për eksport. Ka gjasa që edhe emigrantët shqiptarë të preken nga kjo krizë globale, e cila çon në reduktim të të ardhurave e për rrjedhojë edhe të remitançave. Sipas simulimeve të kryera për këtë shënim vlerësohet se shkalla e varfërisë në Shqipëri mund të rritet me 4 deri në 8 pp, duke shkuar në rreth 40 për qind në skenarin e parë dhe 44 për qind në skenarin e dytë. Kështu pra, sipas skenarit më optimist, varfëria do të arrijë në nivelin e vitit 2012 dhe, sipas skenarit më pesimist, ajo do të ishte e barabartë me nivelin e vitit 2005. Megjithatë shumica e njerëzve që punojnë në bujqësi janë tashmë të varfër, dhe simulimi nuk supozon ulje të të ardhurave në bujqësi, rritja e varfërisë do të vijë kryesisht si rezultat i njerëzve në qytete të cilët punojnë në sektorin e shërbimeve dhe pritet të humbasin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre.

Bosnja dhe Herzegovina: Ngadalësimi ekonomik për shkak të shpërthimit të pandemisë COVID-19, si dhe humbja e mundshme e vendeve të punës dhe të ardhurave prej krizës, ka të ngjarë të ketë një efekt afatshkurtër në varfëri. Të dhënat e fundit për varfërinë në BH i përkasin vitit 2015, kur varfëria ishte rreth 16 për qind, shumë afër nivelit prej 14 për qind të vlerësuar për 2007. Simulimet tregojnë se konsumi ka të ngjarë të bjerë nga 3.5 në 6.7 për qind në të gjithë segmentin e shpërndarjes, kështu që parashikohet që varfëria të rritet nga rreth 11.8 për qind në 2019 në 12.9 deri në 14.6 për qind në vitin 2020. Rreth 35,000 deri në 85,000 individë ka të ngjarë të bien në varfëri në varësi të kohëzgjatjes së krizës nga tre deri në gjashtë muaj. Varfëria ishte rreth 9 për qind në mesin e punëtorëve që punonin në sektorët më të prekur para pandemisë. Sidoqoftë, kjo normë pritet të rritet në 11 për qind sipas skenarit 1 dhe 15 për qind sipas skenarit 2. Aktualisht përbën shqetësim fakti që më shumë se 60 për qind e atyre që mund të bien në varfëri për shkak të krizës së COVID-19 nuk mbulohen nga asnjë program i përkrahjes sociale.

Kosova: Me ndërprerjen e aktivitetit ekonomik dhe rënien drastike të remitançave si rezultat i COVID-19, ka gjasa që efektet në varfëri në Kosovë të jenë të konsiderueshme. Një numër i shumë i madh individësh pritet të humbasin vendin e punës, veçanërisht ata me kontrata me afat të caktuar, punëtorët sezonalë dhe të punësuarit në sektorin informal. Kosova ka një sektor të madh ndërtimi, i cili është veçanërisht i ndjeshëm pasi përbën një burim të rëndësishëm të të ardhurave për shtresat e varfëra dhe të cenueshme në zonat urbane. Në të vërtetë, simulimi i kryer për këtë shënim sugjeron se 57,000 - 148,000 njerëz mund të bien në varfëri, ndërsa klasa e mesme mund të tkurret me rreth 100,000 njerëz. Kjo është ekuivalente me një rritje prej 4-10 pp të shkallës së varfërisë. Megjithatë asistencë sociale është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për të varfërit (rreth 15 për qind në 2017) dhe në njëfarë mase do t'i mbrojë ata nga efektet e krizës, më shumë se gjysma e njerëzve që do të bien në varfëri nuk përfitojnë nga asnjë program aktual i përkrahjes sociale (megjithatë rreth 40 për qind e tyre marrin pension), duke rritur

kështu nevojën për zgjerim të mbulimit dhe ndoshta edhe bujarinë e programit të transfertave në para fizike me qëllim lehtësimin e efekteve nga rënia e të ardhurave.

Mali i Zi: Si rezultat i pandemisë COVID-19, shkalla e varfërisë në Malin e Zi mund të rritet me rreth 1.53 pp, në varësi të kohëzgjatjes së krizës, por pjesa më e madhe e të varfërve të rinj mund të jetë e pambrojtur. Përfundimi do të ishte kthim mbrapa në drejtim të reduktimit të varfërisë gjatë 4-6 viteve të fundit, duke e çuar atë në nivelin e 2015-s, ose edhe të 2013-s. Rreth 9,000 deri në 20,000 qytetarë mund të bien në varfëri si pasojë e shokut ekonomik. Vetëm 6 për qind e punëtorëve në sektorët më të prekur (shiko Tabelën A.1) ishin të varfër para pandemisë, por norma vlerësohet të shkojë deri në 9 për qind në skenarin 1 dhe 13 për qind në skenarin 2. Të ardhurat mesatare të familjeve do të ulëshin nga 5 deri në 10 për qind, më shumë në kuintilet më të larta sepse pjesa më e madhe e të ardhurave të tyre totale vijnë nga sektorët më të prekur nga kriza. Pjesa e popullsisë e konsideruar e cenueshme (as e varfër por dhe as ekonomikisht e sigurt) mund të rritet nga rreth 28 për qind në rreth 29–31 për qind. Shqetësues është fakti që më shumë se 80 për qind e malazezëve që mund të bien në varfëri si pasojë e krizës së COVID-19 nuk përfitojnë aktualisht përkrahje sociale. Për shkak të amortizatorëve të pakët fiskalë, masat e politikave afatshkurtra pritet të jenë të targetuara por Mali i Zi duhet të shqyrtojë mundësitë për zbutjen e efekteve negative tek punëtorët dhe familjet e varfëra dhe të cenueshme.

Maqedonia e Veriut: Efekti i kombinuar i pakësimit të të ardhurave nga puna dhe remitançave për shkak të COVID-19 ka të ngjarë ta kthejë varfërinë në nivelet para 2017-s apo edhe para 2015-s, në varësi të kohëzgjatjes së krizës. Simulimet parashikojnë rritje të shkallës së varfërisë nga rreth 17 për qind në 2019 në rreth 20–23 për qind në vitin 2020, ndërsa 55,000 deri në 130,000 maqedonas (në varësi të faktit nëse kriza zgjat tre apo gjashtë muaj) do të bien në varfëri. Vetëm 4 për qind e punëtorëve në sektorët më të prekur ishin të varfër para pandemisë, por kjo shifër pritet të arrijë në rreth 8 për qind sipas skenarit 1 dhe 15 për qind sipas skenarit 2. Ka të ngjarë që efektet nga shpërthimi i virusit të ndryshojnë përgjatë segmentit të shpërndarjes së të ardhurave; të ardhurat do të bien me rreth 5 deri në 8 për qind për personat në kuintilin më të ulët, dhe 7 deri në 13 për qind ose më shumë për pjesën tjetër të popullsisë. Për më tepër, mbi 75 për qind e atyre që mund të bien në varfëri nuk janë aktualisht të përfshirë në asnjë program të mbrojtjes sociale.

Serbia: Arritjet e fundit të Serbisë në drejtim të uljes së varfërisë mund të përmbysen pjesërisht në 2020-n: në varësi të kohëzgjatjes së krizës, 125,000 deri 327,000 qytetarë mund të bien në varfëri si pasojë e shokut ekonomik. Varfëria në Serbi parashikohet të rritet me 2-4 pikë përqindje, duke arritur në nivelet e viteve 2016–17. Vetëm 8 për qind e punëtorëve në sektorët më të prekur (shiko Tabelën A.1) ishin të varfër para pandemisë, por kjo shifër mund të arrijë në 12 për qind sipas skenarit 1 dhe 19 për qind sipas skenarit 2. Të ardhurat mesatare të familjeve, në të dy skenarët, mund të bien nga 5 deri në 10 për qind — më shumë në kuintilet e mesit të cilat mbështeten në të ardhurat nga sektorët më të prekur nga kriza. Pjesa e popullsisë e konsideruar e cenueshme (as e varfër por dhe as e sigurt ekonomikisht) mund të rritet nga rreth 31 për qind në 33-35 për qind. Shumë prej të varfërve të rinj mund të mbeten pa përkrahje sociale nëse qeveria nuk rishikon programet e përfitimeve. Rreth 66 për qind e serbëve që mund të varfërohen për shkak të krizës së COVID-19 nuk përfitojnë aktualisht përkrahje sociale. Masat afatshkurtra për zbutjen e efekteve tek grupet e varfëra dhe të cenueshme do të plotësonin masat agregate të politikës makroekonomike.

Drejtimet e politikave me bazë të gjerë

Simulimet tregojnë se përveç pasojave shëndetësore, kriza mund të çojë në rritje të ndjeshme të varfërisë dhe tkurrje të klasës së mesme në të gjitha vendet e rajonit. Shumica e të varfërve të rinj dhe personave të cenueshëm nuk janë aktualisht përfitues të skemave të mbrojtjes sociale. Në mënyrë të qartë, si edhe në të gjitha vendet e tjera, prioriteti i parë është kontrolli i përhapjes së virusit dhe mbrojtja

e sistemit shëndetësor. Por në kushtet që masat ekstreme mund të kenë ndikime të mëdha negative sociale dhe ekonomike, veçanërisht për shtresat e cenueshme dhe të varfëra në zona urbane, minimizimi i këtyre humbjeve përbën prioritetin e dytë të politikave në përgjigje të krizës. Në të vërtetë, qeveritë në të gjashtë vendet po përpiqen të ecin në këtë drejtim. Shumica e masave të njoftuara mbështesin punonjës të sektorit formal ose përfitues të programeve ekzistuese të ndihmës sociale, duke lënë të pambrojtur punëtorët e cenueshëm informalë. Politikat me bazë të gjerë të përshkruara këtu prekin dy fusha: ofrimin e shërbimeve bazë sociale, duke përfshirë ruajtjen e investimeve në kapitalin njerëzor, dhe zbutjen e goditjeve në të ardhurat, veçanërisht për punëtorët më të cenueshëm. Përgjigjet specifike diskutohen në detaje në shënimet e tjera të këtij botimi të RER.

Së pari, qeveritë duhet të garantojnë ofrimin e shërbimeve bazë, sigurinë e ushqimeve, strehimin dhe shërbimet bazë të kujdesit social për personat më të cenueshëm. Megjithë masat e ashpra të izolimit dhe aktivitetin e reduktuar ekonomik, ofrimi i shërbimeve bazë si shërbimet utilitare, shërbimet e konektivitetit, menaxhimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e infrastrukturës janë ende thelbësore, veçanërisht për siguruar që njerëzit i respektojnë masat e izolimit. Për më tepër, shumë njerëz në Ballkanin Perëndimor nuk janë pjesë e forcë së punës dhe nuk do të mund të përfitojnë nga shumica e masave të shpëtimit ekonomik. Midis tyre janë dhe grupet më të cenueshme - të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe pakicat etnike - situata e të cilëve mund të përkeqësohet me rënien e remitancave. Do të jetë e rëndësishme që masat në përgjigje ndaj krizës, përfshirë mbështetjet në natyrë, të mundësojnë disponibilitetin e një niveli minimal të garantuar të mbështetjes dhe shërbimeve për ta. Për më tepër, politikat për të mbështetur vijëmbësinë e mësimin për të gjithë nxënësit janë thelbësore për të ruajtur investimet në kapitalin njerëzor dhe për të shmangur thellimin e boshllëqeve të të mësuarit për fëmijët me prejardhjet nga grupet e disfavorizuara.

Së dyti, përgjigjet e politikave duhet të mbrojnë mjetet e jetesës dhe të lehtësojnë rimëkëmbjen, si për të punësuarit në sektorin formal dhe në atë informal. Minimizimi i daljeve të firmës dhe shkatërrimit të vendeve të punës është një hap i parë dhe mund të ketë efekte të rëndësishme pozitive të transmetimit të tyre në sektorin informal përmes kanaleve të ofertës dhe kërkesës. Këto masa janë gjithashtu të nevojshme për të siguruar ruajtjen e një niveli minimal të aktivitetit ekonomik ose që të mund të rifillojë relativisht shpejt pasi të jenë hequr kufizimet e lëvizshmërisë. Më e rëndësishmja, përgjigjet e politikave në mbështetje të të ardhurave duhet të shtrihen për punëtorët që nuk mund të mbulojnë nga programe të mbështetjes së biznesit sepse ata janë të vetëpunësuar ose punojnë në sektorin informal. Shembuj të masave të tilla përfshijnë zgjerimin e programeve të mbrojtjes sociale, programet e punës publike dhe rregullimin e sigurimit të papunësisë.

Aneks 1: Punësimi në sektorët e prekur dhe jo të prekur nga COVID-19

Tabea A.1: Shpërndarja e punësimit sipas sektorëve dhe nivelet e vlerësuara të efektit në rritjen e sektorit

Shpërndarja e punësimit sipas sektorëve (% e numrit të të punësuarve)	ALB	BH	KOS	MKD	MNE	SRB
Bujqësi, gjueti, pyjtari dhe peshkim	33.4	17.1	7.8	11.1	6.2	8.2
Miniera dhe gurore	1.0	2.4	1.9	0.9	0.6	1.9
Prodhim industrial	12.1	11.9	10.6	22.2	5.7	22.1
Shërbime Utilitare	1.9	2.8	3.8	3.4	5.4	2.7
Ndërtim	7.9	10.9	17.0	8.0	5.3	4.3
Tregti me shumicë dhe me pakicë	11.2	13.0	15.5	13.2	19.4	12.4
Transport	3.8	6.4	4.1	4.8	9.1	6.1
Aktivitete të hotelerisë dhe shërbimit ushqimor	6.0	5.0	5.1	5.2	6.3	3.7
Informacion dhe komunikim	0.9	-	2.3	1.9	2.2	3.3
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	0.7	1.9	2.3	1.5	2.5	2.0
Aktivitete të pasurive të paluajtshme		0.9	0.3	0.2	0.2	0.2
Aktivitete profesionale, shkencore, dhe teknike	1.5	-	1.5	2.1	2.7	2.7
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	2.6	-	2.1	2.5	2.0	3.7
Administrata publike	4.9	6.6	4.5	6.3	11.7	5.6
Arsim	5.6	5.1	8.7	5.9	8.9	7.5
Shërbime shëndetësore dhe kujdes social	3.7	5.1	4.5	5.3	6.5	6.7
Art, argëtim, dhe aktivitete të kohës së lirë	0.9	-	1.5	1.6	2.9	2.1
Aktivitete të shërbimeve të tjera	1.4	10.0	5.7	2.7	2.1	3.2
Aktivitete të familjeve si punëdhënës	0.4	0.4	0	0.2	0.2	0.7
Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	0.1	0.5	0.8	0.9	0.2	0.6
Grupimi i aktiviteteve në sektorë sipas shkallës së ndikimit të krizës në rritjen sektoriale						
Shumë të prekur	24.0	19.3	31.7	25.0	33.7	25.5
Mesatarisht të prekur	23.8	39.2	33.6	37.7	22.8	37.6
Relativisht të paprekur	52.2	41.5	34.7	37.2	43.6	36.6

Burimi: Përlllogaritje të bazuara në të dhënat e AMNJ dhe ABF.

Anex 2. Përshkrim i detajuar i metodologjisë

Ky shënim përdor metodën e simulimit për të vlerësuar efektin e mundshëm të pandemisë COVID-19 në shkallën e varfërisë dhe në shpërndarjen e të ardhurave në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Simulimet marrin në konsideratë vlerësimin e përafërt të efekteve të transmetuara përmes shumë kanaleve: të ardhurat nga secili sektor i punësimit, lloji i punësimit dhe transfertat private të familjeve. Në simulimet e kryera nuk janë përfshirë disa efekte, si ai përhapjes së efektit si dhe efektet e rendit të dytë dhe reagimet e sjelljes. Për më tepër, metodologjia nuk mat efektin e drejtpërdrejtë të humbjes së të ardhurave për shkak të sëmundjes; efektet në konsum për shkak të ndryshimeve të çmimeve ose shpenzimeve më të larta të parimbursueshme për kujdesin shëndetësor; dhe dimensionin jomonetar të rënies së mirëqenies.

Tabea A.2: Rënia e të Ardhurave nga Punësimi sipas Sektorëve dhe Llojit të Punësimit (%)

	Skenari 1		Skenari 2	
	Të punësuar me pagë	Të vetëpunësuar	Të punësuar me pagë	Të vetëpunësuar
Shumë i prekur	12.5	25	25	50
Mesatarisht i prekur	6.25	12.5	12.5	25
I paprekur	0	0	0	0

Analiza përdor të dhënat më të fundit të disponueshme të anketave të familjeve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Të dhënat më të fundit të disponueshme për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut¹¹ dhe Serbinë, janë nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetësës (AMNJ) të vitit 2018, e cila i referohet të ardhurave të vitit 2017. Analiza për Malin e Zi përdor të dhënat e të ardhurave për vitin 2015 nga AMNJ 2016, e cila përmban pyetje për njësinë ekonomike familje në lidhje me të ardhurat, kushtet e banimit dhe të jetesës, shëndetin, përjashtimin social dhe karakteristikat socio-ekonomike të anëtarëve të familjes. Për dy vendet e tjera, të dhënat më të fundit të disponueshme janë nga Anketa e Buxhetit të Familjeve 2015 (ABF) e BH¹² dhe ABF 2017 e Kosovës. Këto anketa përmbajnë pyetje për njësinë ekonomike familje në lidhje me të ardhurat, shpenzimet për konsumin final (mallra dhe shërbime), karakteristikat socio-ekonomike dhe gjeografike të familjeve, karakteristikat e anëtarëve të familjes, pjesëmarrjen në tregun e punës, karakteristikat e banesave, dhe përfshirjen sociale dhe opinionin subjektiv të tyre për sistemin shëndetësor dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor. Treguesi matës i varfërisë bazohet në të ardhurat për frymë të familjeve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Mal të Zi dhe shpenzimet për frymë për konsum të familjeve në BH dhe Kosovë.

Analiza mbështetet në efektet e mundshme të krizës në tregun e punës, sipas sektorit dhe llojit të punësimit, përpara çdo mase të ndërmarrë nga qeveritë në përgjigje të krizës. Aktivitetet janë grupuar në sektorë ekonomikë (1) relativisht të paprekur, (2) mesatarisht të prekur dhe (3) shumë të prekur (shiko tabelën A.1). Punëtorët e vetëpunësuar kanë më pak të ngjarë të regjistrohen në skemat e sigurimeve shoqërore dhe mund të mos jenë të përfshirë në masat e qeverive në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme. Efektet e goditjeve brenda këtyre sektorëve supozohet se janë të ndryshme sipas llojit të punësimit (shiko Tabelën A.2). Në skenarin 1 ne supozojmë se të vetëpunësuarit në grupin 3 do të

¹¹ Zyra Shtetërore e Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetësës: Skedari Microdata. Shkup, Maqedonia e Veriut: Zyra Shtetërore e Statistikave.

¹² Agjensia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës, Instituti i Statistikave të Republikës Srpska dhe Instituti i Statistikave të Federatës Bosnje dhe Hercegovina. Anketa e Buxhetit të Familjeve: Skedari Microdata.

humbasin të ardhurat e një tremujori (25 përqind të të ardhurave vjetore), në grupin 2 do të humbasin gjysmën e të ardhurave të tyre në këtë tremujor (12.5 përqind), dhe në grupin 1 të ardhurat e tyre nuk do të preken. Goditja në të ardhurat e të punësuarve me pagë pune supozohet të jetë më e vogël: 12.5 përqind në grupin 3, 6.25 përqind në grupin 2, dhe asnjë ndikim në grupin 1. Në skenarin 2 ne supozojmë se pandemia zgjat për dy tremujorë, dhe humbjet e të ardhurave janë dyfishi i atyre në skenar 1. Ne gjithashtu supozojmë se transfertat private do të zvogëlohen me 40 përqind gjatë një tremujori të vitit. Efektet janë simuluar duke zbritur humbjen në të ardhurat nga punësimi dhe nga remitancat familjare nga të ardhurat për frymë të familjeve dhe duke krahasuar këto skenarë me nivelin bazë.